



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 27.09.2019, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha i pavarur, Suzan Kika, e pavarur, Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri i pavarur dhe Baton Dushi (Nisma).

**Munguan:** Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Uran Ismaili (PDK), Migjen Shala (PDK) dhe Valbona Petrovci, e pavarur.

**Të pranishëm ishin edhe:** Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Adonis Tahiri, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit.

Prezent ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të e medjeve të shkruara dhe elektronike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Osman Bllaca** propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika: Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrri, kërkesë e cila ka ardhur nga Ministria e Kulturës.

**Egzon Azemi** kërkoi një sqarim nga kryetari, rreth gjendjes së ish-shkollës së mesme teknike, tani gjimnazi "Ahmet Gashi", ku sipas ekspertëve është konstatuar se objekti nuk ka siguri të mjaftueshme për mbajtjen e mësimit, por tani këtë objekt është duke e shfrytëzuar KKZ-ja dhe KQZ-ja.

**Agim Gashi** tha se edhe më herët kam kërkuar që në rend të ditës të jetë edhe pika "Raportimi i policisë për çështje të sigurisë në komunën e Prishtinës", por propozimi nuk është marrë parasysh.

Po ashtu, është dashur të jetë si pikë e rendit të ditës edhe raporti për përgatitjet rreth fillimit të vitit shkollor, dhe në kuadër të kësaj pike do të diskutonim edhe për gjendjen e sigurisë së objektit të shkollës "Ahmet Gashi", si dhe rreth rastit të helmimit të nxënësve me ushqimin e kuzhinës së shkollës fillore "Elena Gjika", e cila është aktivizuar pa procedura përkatëse.

**Osman Bllaca** theksoi se kemi diskutuar me policinë e Kosovës, mirëpo ata nuk kanë qenë të gatshëm që të na sjellin informata për sigurinë në shkolla ashtu siç është kërkuar. Në fillim të muajit tetor, KKSB-ja do ta mbanë një mbledhje, ku do ta kemi edhe një raport nga Policia e Kosovës.

**Rifat Deri** tha se është për t'u falënderuar kryetari dhe nënkryetari i Komunës, për panonë që e kanë bërë dhe që Prishtina është shpallur qyteti më transparent në Evropë.

**Suzan Kika** u shpreh se kam kërkuar që në rend të ditës të futet edhe pika për ndërtimin e shkollës së muzikës "Prek Jakova", andaj kërkoj shpjegim se ku është problemi për mos ndërtimin e kësaj shkolle.

**Kryesuesi** konstatoi se më 34 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi që në rend të ditës të futet edhe pika "Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrri".

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ky**

**REND I DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2020 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2020-2022(KAB);
3. Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin e punës në shkolla fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, 01. nr. 031-142411, dt. 09.06.2016;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban ( Sulejman ) Ramadanit;
5. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr. 01. 463/01-0101088/19, dt. 03.05.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB);
7. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën " Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" ( Bahri Fazliu), pjesa jugore, 2019-2027;
8. Propozimvendimi për miratimin e Vendimit për lënien në dispozicion të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria" - pjesa e kolektorit;
9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e bustit të senatorit amerikan Robert Doll;
10. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrri;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit.**

Agim Gashi bëri vërejtje, duke thënë se në ekstrakt të procesverbalit duhet të shënohen me emër dhe mbiemër edhe drejtorët pjesëmarrës në mbledhjen e Kuvendit.

**Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

## Pika e dytë

### Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2020 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2020-2022 (KAB).

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me këtë pikë.

**Valbona Makolli**, drejtoreshë, tha se hartimi i buxhetit të Komunës së Prishtinës është bërë pas mbajtjes së pesë dëgjimeve buxhetore me qytetarë dhe një dëgjim buxhetor që është bërë nga Kuvendi komunal, së bashku me anëtarë të KPF-së.

Shumica prej atyre dëgjimeve buxhetore që kanë qenë, janë përfshirë në hartimin e buxhetit të vitit 2020, si dhe propozimet të cilat i ka dhënë Kuvendi komunal dhe partitë e ndryshme përfaqësuesit e të cilave kanë qenë të pranishëm.

Buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2020 është në vlerë prej 91 milionë 579.504 euro. Sa i përket Komunës së Prishtinës, për "të hyrat vetanake", sipas të njëjtës qarkore që është pranuar nga Ministria e Financave, janë planifikuar 29 milionë e 258.367 euro, kurse sa i përket grantit qeveritar të kryeqytetit, për vitin 2020 është diku mbi 11 milionë euro. Buxheti është ndarë nëpër kategoritë ekonomike, në "paga dhe mëditje", "mallra dhe shërbime", "komunale", "subvencione" dhe "kapitale".

Krahasuar me vitin 2018, buxheti i Komunës së Prishtinës ka një rritje prej 3 milionë 845.679 euro dhe kjo kryesisht ka shënuar një rritje te kategoria "paga dhe mëditje".

**Agim Gashi** tha se sa i përket të hyrave vetanake nuk shohim ndonjë lëvizje dhe ky planifikim nuk është në përputhshmëri me kornizën afatmesme buxhetore 2019-2021, sepse ne e kemi miratuar një planifikim prej 31 milionë euro të të hyrat vetanake.

Sa i përket shpërndarjes së buxhetit, mendoj se opozita fare nuk është konsultuar, që do të ishte praktikë e mirë me bashkëpunuar me opozitën, për hir të qytetarëve të komunës së Prishtinës, pasi që ka shumë projekte të rëndësishme, që drejtpërsëdrejti ndikojnë në fushën e arsimit, në fushën e mirëqenies jetësore, siç janë kanalizimet, pastaj trotuaret etj. Në planifikimin e këtij buxheti nuk figuron renovimi i shkollës "Ahmet Gashi" dhe për këtë projekt mendoj se ai objekt nuk është në gjendje për t'u rritur, së paku në kontaktet që kam pasur me inxhinierët, sepse është një objekt që krijon njëfarë identiteti në atë mes. Ka shumë projekte që do të ishin me prioritet për futjen në planifikim për buxhetin e vitit 2020, siç janë furnizimi me ujë për fshatrat e gollakut, Mramor, Busi dhe Grashhticë, si dhe shtrirja e rrjetit të kanalizimit në fshatin Llukar, por edhe rregullimi i kolektorit për grumbullimin e ujërave të zeza në Prishtinë. Gjithashtu kërkoi sqarim rreth projektit për ndërtimin e tunelit në rrugën "Agim Ramadani", projekt i cili është paraparë në buxhet. Në këtë buxhet nuk janë përfshirë edhe disa segmente të rrugëve të fshatrave, si ajo në Zllashë, Gulimivadë, pra do të ishte mirë që t'i prekim edhe ato lagjet ku ka banorë. Kërkoj nga ekzekutivi që së bashku me qenë sa më vendimmarrës dhe që këto vendime të jenë sa më realizuese.

**Mirsad Vitia** tha se me këtë propozimbuxhet, gjatë vitit të ardhshëm do të kemi rënie të burimeve vetanake mbi 2.5 milionë euro në krahasim me vitin e tanishëm 2019.

Gjithashtu, nëse e krahasojmë propozimbuxhetin për 2019 me këtë që kemi, kuptojmë se në tabelë mungon pozicioni buxhetor financimi nga huamarrja. Shtrohet pyetja pse, shkaku i Ligjit për kryeqytetin apo cila është arsyeja?

Disa nga drejtoritë komunale planifikojnë të kenë më tepër buxhet vitin e ardhshëm, por në anën tjetër zvogëlon numrin e projekteve, si p.sh. Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave. Pra kot e rrit buxhetin, kur në anën tjetër nuk i shpenzojnë mjetet për ato projekte të parapara.

Lidhur me buxhetin e vitit 2020 ngriti shqetësim, duke cekur se:

1. A nuk ju duket shumë 2.5 milionë euro ndërtimi i tunelit 300m, në rrugën "Agim Ramadani"?
2. Projekti 7 dhe 8, "Ndërtimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale me infrastrukturë përcjellëse", ku planifikohen 3.8 milionë euro, të ceket cilat rrugë konkretisht;
3. Ku do të bëhet ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe i ujërave në komunën e Prishtinës?
4. Implementimi i Planit të mobilitetit, pjesa urbane, na intereson të dimë zonën, apo cilën pjesë të lagjeve të qytetit.

Shikuar në përgjithësi, edhe te drejtoritë e tjera planifikimet për realizimin e shumë projekteve kanë mbetur vetëm premtime, si p.sh. projekti për ndërtimin e Qendrës së Kulturës në Hajvali, e cila ka qenë kërkesë e kahershme e banorëve të asaj lagjeje.

Edhe Drejtoria e Sportit ka paraparë një mori projektesh për realizim, andaj pyes se:

1. Ku planifikohet ndërtimi i fushave sportive?
2. Ku planifikohen shtigje për ecje dhe vrapim, shenjëzim dhe infrastrukturë?
3. Ku planifikohen shtigje për vrapim, tri, të ngjashme me shtegun në parkun "Taukbaçe", "Gërmia", "Arbëria" e të tjera?
4. Ku planifikohet shteg për vrapimi në zall?

Nëse këto vërejte dhe sugjerime nuk merren parasysh nga ekzekutivi, pra nëse nuk shqyrtohen dhe plotësohen, vota ime për këtë propozimbuxhet nuk do të jetë pozitive. **Leutrim Retkoceri** theksoi se buxheti i propozuar për miratim nga qeverisja e Komunës së Prishtinës meriton një diskutim të shtruar e konstruktiv, për shkak se është vendimi më i rëndësishëm i Komunës së Prishtinës, që është buxheti për vitin 2020.

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve në buxhetin e vitit 2020 për Prishtinë, ka një pamje tradicionale, me shpërndarje në paga, mallra, shërbime e subvencione, por, fatkeqësisht, nuk ka një pamje moderne të ndërtuar në buxhet me program dhe shërbime për qytetarët e Prishtinës.

Nuk është buxhet i ndërtuar me prioritet më të rëndësishme të politikave dhe nuk ka një alokim të mjeteve financiare në përputhje me rrethanat dhe nevojat që ka kryeqyteti ynë, Prishtina. Qeveria komunale nuk ka përfillur tri instrumentet më të rëndësishme planifikuese në këtë buxhet, që janë: korniza afatmesme e shpenzimeve, plani zhvillimor komunal dhe plani zhvillimor urban, pra nuk janë të përfillura në këtë buxhet.

Mungesa e takimeve adekuate me qytetarë për të diskutuar prioritet po prodhon një propozim buxhet, që në sektorin e arsimit nuk ka as dy shkolla që do të fillojnë me u ndërtuar në vitin 2020. Pra, kemi edhe shumë projekte të tjera të drejtorive komunale të cilat nuk janë realizuar. Ky është një buxhet i planifikuar dobët, jo specifik dhe i cili nuk prodhon rezultatet e pritura të prioriteteve.

Buxheti i Komunës për vitin 2019 ishte 82.7 milionë euro, ndërsa buxheti i vitit 2020 parashihet të jetë 91.5 milionë euro.

Me të gjitha këto që u thanë, grupi i anëtarëve të Kuvendit të Prishtinës nga radhët e PDK-së, nuk do ta përkrahë buxhetin e përgjysmuar. Buxheti i vitit 2020 duhet të rishikohet, së bashku me të edhe kodet buxhetore.

**Fiknete Bejta** tha se edhe ne e kemi analizuar projektbuxhetin për vitin 2020, dhe kemi parë se është respektuar barazia në secilën kategori, janë respektuar parimet e buxhetit, andaj dhe e përkrahim si tërësi për miratim.

**Sami Boroci** u shpreh se edhe ne e kemi trajtuar dhe shqyrtuar buxhetin dhe kornizën afatmesme buxhetore, andaj dhe do ta përkrahim për miratim. Kemi parë që ka një planifikim dhe një shpërndarje të mirë për pjesët rurale dhe pjesën urbane të komunës së Prishtinës.

**Shefki Gashi** ngriti një shqetësim rreth mungesës së ujit në pjesët rurale, kryesisht në periferi të Prishtinës, duke thënë se furnizimi me ujë i vendbanimeve më të dendura në periferi të Prishtinës është shumë i nevojshëm, prandaj nëse nuk futet në buxhet projekti për rrjetin e ujësjellësit për këto vendbanime, posaçërisht prej fshatit Llukar, Mramor, Busi e deri në Slivovë, grupi ynë parlamentar nuk do ta votojë buxhetin për vitin 2020. Po ashtu, kërkoj që në buxhet të parashihet edhe projekti për rregullimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Llukar.

**Hafiz Krasniqi** tha se shikuar nga aspekti i të hyrave, shohim se kemi një buxhet mjaft voluminoz, andaj dhe kur e analizojmë brendësinë e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore, veçmas të investimeve kapitale, ato që janë të lidhura me infrastrukturë në përgjithësi, len përshtypje se ky buxhet sikur i është dedikuar vetëm pjesës urbane, duke abstrahuar në masën 80% të fshatrave dhe pjesës rurale. Andaj, kërkoj që të ndryshohen disa pozicione, pra të kemi disa shkurtime në pozicione të caktuara dhe mjetet të destinohen në pozicione gjegjëse. Kur kemi parasysh rëndësinë e investime kapitale, që është leva kryesore e buxhetit, propozoj që pozicioni 143, pika 9, ndërtimi i kanalizimeve fekale, në komunën e Prishtinës, ku janë të parapara shuma e mjeteve financiare prej 400.000 euro, të rritet një shumë prej 350.000 euro dhe kjo të jetë 750.000 euro.

Konkretisht, kërkoj dhe pres mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Kuvendit në përkrahjen për realizimin e projektit të rrjetit të kanalizimit nga Bunari i Hajratit deri në Llukar, Makofc e Grashticë.

**Naime Osmani** fillimisht ngriti një shqetësim, duke thënë se nga dy mandatet me këtë qeverisje, asnjë kërkesë e imja nuk është përfshirë në projekt për realizim, nuk kanë hyrë as në këtë kornizë afatmesme buxhetore për vitin 2020. Sa i përket projekteve, si ajo për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, nuk është paraparë për pjesët rurale, gjë që na ka kushtuar edhe me shumë aksidente, sidomos në rrugën Besi - Rimanishtë. Po ashtu, ka shumë rrugë në këto pjesë, të cilat janë më se të domosdoshme për ndërtim, që asnjë nga ato nuk ka hyrë në projekt për vitin 2020.

Projekti për rrënimin e ish-Shkollës teknike, tani gjimnazi "Ahmet Gashi", konsideroj se është i gabuar, ajo shkollë duhet të rinovohet. Në shumë fshatra të zonave rurale

mungojnë kënde të lodrave, mungon rrjeti i kanalizimit, në shumë rrugë janë formuar gropa, të cilat asnjëherë nuk janë sanuar. Po ashtu, mungon subvencionimi i shoqërive kulturo-artistike etj. Andaj, kërkoj nga ekzekutivi që këto kërkesa të parashihen në buxhetin e vitit 2020.

**Eman Rrahmani** kërkoj që në buxhetin e vitit 2020 të hyjnë si projekte, ndërtimi i shkollave të reja në Vranidoll dhe në Shkabaj, pasi që ato ekzistueset paraqesin rrezik për nxënësit. Të përfshihet në projekt ndërtimi i rrugës "Xhevat Begolli" në komunën e Prishtinës dhe të zgjidhet problemi rreth ndërtimit të rrugës "Nebil Duraku". Të parashihet në buxhet edhe ndërtimi i parkut në lagjen "Kodra e Trimave". Në shkollën "Andon Zako Çajupi" në Bardhosh, të rinovohet fusha sportive, të bëhet rregullimi i shkallëve, izolimi i kulmit, si dhe ndërtimi i këndit të lojërave. Të rregullohet instalimi i rrymës elektrike në shkollën "Zenel Hajdin", ku ky instalim është në gjendje të mjerueshme. Të rregullohet salla e sporteve në shkollën "Asim Vokshi", të bëhet inventarizimi i sallës me pajisje sportive, kabineti i informatikës, si dhe të bëhet lysterja e shkollës përbrenda.

Kërkoj që të gjitha këto kërkesa të përfshihen në buxhetin e vitit 2020.

**Arbër Vokri** tha se po ta analizojmë në detale këtë projektbuxhet, shihet se nuk ka rritje, madje vërehet tendencë e uljes së buxhetit për shëndetësi, dhe kjo për mua është absurde, duke e ditur se çfarë nevojash ka Drejtoria e Shëndetësisë në Prishtinë. Një prej kritereve bazë do të duhej të ishte numri i shërbimeve që kryen sektori i Mjekësisë Parësore, i kemi diskutuar edhe herëve të tjera. Do të thotë është kryeqytet, ku vijnë edhe qytetarë nga komunat tjera, marrin shërbim në këmbim të një pagese simbolike, edhe kjo e ngarkon jashtëzakonisht shumë sistemin. Kisha sugjeruar që në planifikimin e buxhetit për vitin 2020, të merret parasysh ky kriter.

Po ashtu, QKMF-ja është duke punuar me deficit financiar edhe për shkak të mungesës së buxhetit, nuk po mundet as me shpallur konkurse për vende të reja të punës. Po ashtu, u mungojnë edhe pajisje të tjera shëndetësore etj.

Ka shumë zona të qytetit që nuk ka ndriçim, sidomos në lagjen "Dardania", ku një pjesë e rrugëve janë të pakryera, po ashtu i papërfunduar edhe projekti kryesor të Kurri. Andaj, duke pasur parasysh këto që u cekën, kërkoj që këto kërkesa të përfshihen në buxhetin e vitit 2020.

**Mustafe Krasniqi**, në emër të banoreve të një pjese të rrugës "Xheravica", e cila lidh rrugën "Hasan Remniku" me rrugën "Luan Haradinaj", apo rrugën që e lidh Kolovicën e Re me Kolovicën e Vjetër, kërkoj që të bëhet ndriçimi i saj.

Po ashtu, e përkrahu edhe kërkesën e parafolësve rreth furnizimit me ujë për fshatrat e Gollakut, e posaçërisht zgjidhjen e problemit të rrjetit të kanalizimit prej fshatit Grashticë deri te Fusha e Pajtimit.

**Jeta Rafuna Hasani** kërkoj që në buxhetin e vitit 2020, të parashihet ndërtimi i një shkolle, të cilën e kanë kërkuar tash e sa vjet banorët e Sofalisë, afër rrugës "Blendi". Unë propozoj që shkollla e mesme "Gjin Gazulli" me u zhvendosur në një pjesë tjetër të Prishtinës dhe ky objekt të parashihet për shkollë fillore.

Gjithashtu kërkesë e qytetarëve është që te Fusha e Pajtimit të ketë një fushë sportive, aty ku është paraparë, ku tash për tash është komplet e mbuluar me mbeturina.

Edhe banorët e Kolovicës kanë kërkuar një fushë sportive dhe kënde të lojërave.

Kërkoj të dijë se a ka paraparë ndonjë projekt Drejtoria e Investimeve Kapitale për mbikalim mbi hekurudhë, te rruga "Ekrem Rexha", që e lidh këtë pjesën tjetër te Sheshi 21. Banorët afër rrugëve "Azem Babiqi" dhe "Indriz Ajet Gashi", në lagjen "Tasligje" kanë kërkuar asfaltimin e atyre rrugëve dhe ndriçimin e rrugës. Kërkoj të dijë se a do të ketë shtrirje të rrjetit të Termokosit te Banesat e Bardha në lagjen "Bregu i Diellit".

**Egzon Azemi** ngriti shqetësimin rreth realizimit të premtimeve të dhëna nga kryetari i Komunës, duke thënë se projektet që bashkërisht kemi thënë se kemi me i realizuar, a janë realizuar deri sot, edhe deri kur kanë me u realizuar. Është dashur të organizoheshin tubime publike me qytetarë, të dihet sa pjesëmarrës kanë qenë në dëgjime publike rreth buxhetit etj. Pse nuk mundemi me bërë një grup që i fton të gjithë qytetarët, ku janë edhe partitë politike, edhe organizatat joqeveritare, ku IMPO, në këtë rast, ka shprehur gatishmëri me ndihmuar me të gjithë infrastrukturën që e ka, në mënyrë që debatet publike për këtë çështje me qenë me qytetarë.

**Kushtrim Sopa** kërkoj që në buxhetin e vitit 2020 të përfshihet edhe shtrirja e rrjetit të Termokosit edhe në lagjet e vjetra të qytetit. Kërkoj që të bëhet ndriçimi i pakut në lagjen "Arbëria" dhe rrugët përreth këtij parku, si dhe ndriçimi i të gjithave parqeve të tjera. Të përfshihet në buxhet edhe ndriçimi i rrugëve në lagjen "Bregu i Diellit", konkretisht rruga "Hyzri Talla", të bëhet shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në lagjen "Arbëria", që banorët e ri të pjesës "Arbëria 3" dhe pjesa e sipërme kanë problem me ujin gjatë ditës, dhe të parashihet renovimi i banesave në lagjen "Ulpiana".

**Fadil Gashi** tha se ne të gjithë e dimë se buxheti në Komunën e Prishtinës është rritur dhe është më se e domosdoshme që ..... për fshatin Mramor të parashihet në buxhetin e vitit 2020 projekti për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

*Duke pasur parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, Shpend Ahmeti, kryetar, propozoi që për buxhetin e vitit 2020 të bëhen këto ndryshime në këto kode buxhetore: Linja 1.4.3, ndërtimi i tunelit në rrugën "Agim Ramadani" prej 2 milionë 493.000 euro, bëhet 2 milionë euro, ndërsa 493.000 euro rialokohen në linjë të re buxhetore. Kanalizimi në Llukar, Makovc - 250.000 euro, ujësjellësi Grashticë, Mramur, Busi, Slivovë - 200.000 euro edhe renovimi i shkollës "Ahmet Gashit" 43.000 euro. Po ashtu, shtohet linja buxhetore, pagesa e interesit për kredi 110.000 euro, prej subvencione të Administratës në transfer të veçantë për BERZH-në.*

**Kryesuesi konstatoi se me 35 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2020 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2020-2022 (KAB).**



#### **Pika e tretë**

**Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin e punës në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, 01. nr.031-142411, dt. 09.06.2016.**

**Osman Bllaca** tha se lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin e punës në shkolla fillore të mesme të ulëta, kemi propozuar që nenit 32, t'i shtohet paragrafi 32.6, ku thuhet: "Mësimdhënësi ka të drejtë të kërkojë pensionim të parakohshëm, me 70% të pagës bazë, duke filluar nga mosha 60 vjeçare, si rezultat i gjendjes së rëndë shëndetësore, të cilën duhet ta dokumentoj me raporte shëndetësore".

**Halim Halimi** tha se një pjesë e madhe e mësimdhënësve të cilët e arrijnë moshën 60 vjeçare, kanë probleme të rënda shëndetësore, andaj duhet të aplikojnë për të kaluar në pensionim të parakohshëm, me 70% të pagës bazë, dhe kur të arrijnë moshën 65 vjeçare me fituar pensionimin e parakohshëm, unë besoj që është mirë dhe duhet të aprovohet. E përkrahim propozimin që të aprovohet neni 32. 6.

**Valbona Ajeti** tha se e shohim si të nevojshëm ndryshimin e kësaj rregulloreje dhe është e mirëpritur, pasi që e dimë se në shumë shkolla kemi mësimdhënës të cilët punojnë me shëndet jo të mirë dhe mosha e tyre është rreth 60 vjeç, e shëndeti i tyre nuk ua lejon të punojnë deri në atë masë për me e dhënë kontributin e tyre ashtu si duhet.

Grupi i asamblistëve të AAK-së e mbështet këtë rregullore për ndryshim.

**Agim Gashi** propozoi që neni 32.6 të formulohet më mirë, pra duke mos i përjashtuar edhe kategoritë tjera profesionale, siç janë: drejtorët, zëvendës drejtorët, pedagogët, pra përveç mësimdhënësve, të parashihen edhe kategoritë tjera të shërbimeve profesionale të shkollës.

**Me propozimet e dhënë për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 32.6 dhe propozimin e z. Agim Gashi, kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, 01. nr. 031-142411, dt. 09.06.2016.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban ( Sulejman ) Ramadani.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sulejman ) Ramadani.**

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr. 01.463/01-0101088/19, dt. 03.05.2019, për këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private.**

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr. 01.463/01-0101088/19, dt. 03.05.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private.

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme, në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB).**

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 28 vota për, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB).

**Pika e shtatë**

**Ppropozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" ( Bahri Fazliu ), pjesa jugore, 2019-2027.**

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 29 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" ( Bahri Fazliu ), pjesa jugore, 2019-2027.

**Pika e tetë**

**Ppropozimvendimi për miratimin e Vendimit për lënien në dispozicion të projekt dokumentit të Planit rregullues të hollësishëm, për zonën e lagjes "Kalabria"- pjesa e kolektorit.**

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e Vendimit për lënien në dispozicion të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria"- pjesa e kolektorit.

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e bustit të senatorit amerikan Robert Doll.**

Mirsad Vitia tha se në parim jemi për këtë propozimvendim, mirëpo kërkoi të dijë se a është bërë kërkesë zyrtare në Agjencionin Kosovar të Privatizimit (AKP), sa i përket parcelës kadastrale 7232-0, e cila është në pronësi të ish-ndërmarrjes shoqërore industria e tekstilit "Napredak", ku do të vendoset busti i senatorit Robert Doll, pasi që me prona shoqërore menaxhon AKP-ja dhe jo Komuna e Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e bustit të senatorit amerikan Robert Doll.

**Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrri.**

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrri.**

**Pika e njëmbëdhjetë  
Pyetje dhe përgjigje.**

**Kushtrim Sopa, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

1. Si do të parandalohen ndaljet e panevojshme të linjave të autobusëve: 7, 7a, 7b prej Tregut të gjelbër deri në Kolovicë, si dhe prej shkollës "Sami Frashëri" deri në Kolovicë, ngase linjat e lartcekura panevojshëm ndalen pothuajse çdo 10 metra të rrugëve përkatëse?
2. A do të merren masa për çlirimin e rrugës "Muharrem Fejza" nga komunikacioni i stërngarkuar, duke përmirësuar infrastrukturën aktuale rrugore dhe atë përcjellëse në rrugicat që lidhen me këtë rrugë si pike kyçe e qarkullimit, duke ofruar parkingje shtesë dhe zgjerimin e rrugës?
3. Pse trajtimi i qenve endacakë ka mbetur vetëm në letër, ngase pothuajse në çdo cep të qytetit mund të hasësh në turma të tyre?
4. Kush i mbulon kanalet e hapura nga ndërmarrja "Termokos", tani janë bërë 2 të tilla në rr. "Hajdar Dushi"?
5. A do të rregullohet ndriçim i rrugës Hyzri Talla, apo te banesa e ish-presidentes, ngase tani 20 vjet kanë kaluar dhe ende nuk ka ndriçim në këtë rrugë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**



Faqe 11 nga 11